

Konsultimet me komunitetin lokal mbi iniciativën për themelimin e KOMRA- së

**Pejë, Kosovë
28. janar 2010.**

Konsultimet janë organizuar nga organizata joqeveritare Syri i Vizionit (Kosovë) në bashkëpunim me Fondin për të Drejtën Humanitare Kosovë. Në takim kanë marrë pjesë 37 pjesëmarrës, anëtarë të familjeve të viktimave, shoqatave të familjarëve të të zhdukurve, veteranëve dhe invalidëve ushtarak të luftës si dhe përfaqësuesve të organizatave joqeveritare. Z. Veton Mujaj ka folur mbi temën Pse KOMRA, ndërkaq Nora Ahmetaj (aktiviste e të Drejtave të Njeriut, Kosovë) dhe Bekim Blakaj (Fondi për të Drejtën Humanitare) kanë njoftuar pjesëmarrësit mbi rrjedhën e deritanishme të procesit konsultativ dhe eksperiencën pozitive të komisioneve të tjera për të vërtetën dhe pajtim në botë. Moderatore e diskutimit ishte Besarta Vasija (Fondi për të Drejtën Humanitare, Kosovë). Pas përfundimit të konsultimeve 34 individ dhe përfaqësues të organizatave kanë nënshkruar deklaratën mbi bashkëngjitje në koalicionin për KOMRA.

Opinionet, propozimet dhe rekomandimet e pjesëmarrësve:

KOMRA duhet të zbardh rastin e secilës viktimë.

[...] Për fat të keq ose fatmirësisht, nuk di se si të shprehem, kemi punë me një shtet i cili nuk e njeh gjuhën e dialogut. Ju kisha lutur juve që e filluat këtë iniciativë dhe ju uroj dhe dëshirojë sukses në të ardhmen, që të ndërmerrni hapat konkret ngase keni mbështetjen tonë si familje, aq sa kemi mundësi, në mënyrë që të zbardhet rasti i secilës viktimë, secilit person të zhdukur në tërë territorin brenda Jugosllavisë e posaçërisht në Kosovë. (Emine Bytyqi, Raushiq, Kosovë, Konsultimet me komunitetin lokal, Pejë, 28 janar 2010).

Nuk duhet falur kriminelët

(...) po e mbështes nismën të cilën e iniciuat, si dhe secilin që e nisë këtë iniciativë. Është thënë se ju tani kërkonit përgjigjet tona direkte ... A të falen kriminelët? Jo! Pse për diçka tjetër e tërë bota nuk i'u fal? Ju përmendët disa shtete. Ju duhet të thoni ashtu, por edhe sot e kësaj dite janë duke u kërkuar ata nga Aushvici, kërkojen edhe njerëz të tjerë që të dënohen për krimet e bëra, nga se nuk dënohen kriminelët ata nesër prapë do të kryejnë krime. (Tahir Rraci, ish i burgosur politik nga burgu i Dubravës, Kosovë, Konsultimet me komunitetin lokal, Pejë, Kosovë, 28 janar 2010).

(...) ne mezi presim që një kriminel të jetë dënuar dhe të shohim që ka marrë dënimin e merituar, e ky kërkim i faljes më duket si diçka që nuk mund as t'a shqiptoj, për ne që jemi viktimë, ose për kriminelët që ecin lirshëm dhe pa asnjë frikë nga askush. (Emine Bytyqi, Raushiq, Kosovë, Konsultimet me komunitetin lokal, Pejë, 28 janar 2010).

Falja do të mund të jetë e kushtëzuar me dhënien e informatave mbi kriminelët.

(..) nëse një kriminel ofron diçka, për shembull zbardhjen e rastit në fshatin tim dhe tregon se janë aty, ndoshta do të vinte në konsiderim që t'i falet. (Emine Bytyqi, Raushiq, Kosovë, Konsultimet me komunitetin lokal, Pejë, 28 janar 2010).

Është herët që të diskutohet se si do të duket komisioni.

Mendimi im është se do të keni mbështetje, por se si do të duket komisioni, ka kohë që për këtë të diskutohet. Nëse komisioni ratifikohet nga parlamentet e këtyre shteteve atëherë do të bisedojmë përsëri mbi modalitetet e komisionit. (Tahir Rraci, ish i burgosur politik nga burgu i Dubravës, Kosovë, Konsultimet me komunitetin lokal, Pejë, Kosovë, 28 janar 2010).

KOMRA është një propozim i kot

Dhashtë zoti që të keni sukses! Dhashtë zoti që të na ndihmoni në këtë rast! Dhashtë zoti që ai që punon për këtë popull të jetë i ndihmuar dhe i bekuar nga zoti! Por më duket se kot po na mundoni ngase nuk ka asgjë. Ju dëshiroj suksese! (Isa Gashi, kryeplak i fshatit Pavlan, Kosovë, konsultimet me komunitetin lokal, Pejë, Kosovë, 28. janar 2010).

KOMRA duhet që krahas familjeve të të zhdukurve të kyç edhe shtetin.

Po, unë jam i mendimit se duhet të jenë edhe familjarët e të zhdukurve, por paraprakisht do të ishte e udhës që me këtë të merret shteti, e veçanërisht një delegacion shtetëror – edhe familjarët e viktimave të zhdukura gjithsesi, por shteti duhet të merret në rendë të parë. Tani po thonë se jemi bërë shtet dhe se shteti ka një peshë më të madhe, e veçanërisht dikë nga anëtarët e familjeve të viktimave apo të zhdukurve. (Emine Bytyqi, Raushiq, Kosovë, Konsultimet me komunitetin lokal, Pejë, 28 janar 2010).

Kjo qeveri, e cila që 10, 11 vite nuk mundet asgjë, unë nuk kam aspak shpresë te ajo. Nëse nuk janë anëtarët e familjeve në këtë komision atëherë do ta di se asgjë nuk kanë bërë. (Isa Gashi, kryeplak i fshatit Pavlan, Kosovë, konsultimet me komunitetin lokal, Pejë, Kosovë, 28. janar 2010).

Hapi i parë i takon Serbisë: Të pranoj dhe të kërkoj falje në mënyrë publike

A duhet shkuar kah ajo që ne t'i kërkojmë falje Serbisë? Së pari Serbia duhet t'i pranoj krimet të cilat i ka kryer dhe atëherë i mbetet nderit dhe ndërgjegjes tonë se çka do të ndërmarrim si hap të ardhshëm, por ne jemi hapi i dytë. I pari i takon Serbisë. Ajo ka kryer krime dhe ajo duhet të kërkoj falje publikisht. (Tahir Rraci, ish i burgosur politik nga burgu i Dubravës, Kosovë, Konsultimet me komunitetin lokal, Pejë, Kosovë, 28 janar 2010).

Afati prej tre vitesh shumë i shkurtër për punën e komisionit.

Unë nuk mendoj se për tre vite por për njëmbëdhjetë nuk është mundur të kryhet. Shikoni se çka janë duke bërë për Sheshelin, unë kërkoj falje, por ja sa gjatë po i gjykohet Sheshelit, Haga nuk mund t'a përfundoj e ju po mendoni që për tre vite të kryeni punë. E tërë bota ka dëshmuar se është kriminel dhe nuk mundet të dënohet, ndërkaq ju mendoni të kryeni punë për tre vite. Më të vërtetë nuk do të mundet. (Jonuz Gutiq, fshati Raushiq, Kosovë, Konsultimet me komunitetin lokal, Pejë, Kosovë 28. Janar 2010).

Duhet të përcaktohet periudha me të cilën do të merret komisioni.

Unë pajtohem që ju të merreni me krime të kryera nga viti 1990 deri në vitin 1999. Ndërkaq për krimet e kryera më vonë ekziston qeveria, policia, gjykatat dhe të tjerët që duhen të merren me këtë ngase krimet kanë ndodhur gjatë mandatit të tyre. (Isa Gashi, kryeplak i fshatit Pavlan, Kosovë, konsultimet me komunitetin lokal, Pejë, Kosovë, 28. janar 2010).

Ju thatë se në përbërjen e komisionit do të jenë edhe historianët dhe psikiatrit. Nëse ndonjëri nga historiani fillon nga vitet e 80-ta, atëherë ai nuk është historian por është njëri që ka përjetuar atë çka edhe unë kam përjetuar. Nëse ja fillon nga viti 1912 mbi vuajtjet e shqiptarëve dhe deri te viti 1945 sa njerëz ishin nëpër burgje në Pejë dhe sa prej tyre kurrë nuk kanë dalë pa paraqitje në gjyq, sa tortura i kemi pasur. Më kujtohen vitet 45, 47, 56, 63 të gjitha më kujtohen. Mendoj se historiani të gjitha i thekson nëse edhe ai i ka përjetuar...(..)...kur është fjala për atë se dëshironi të filloni nga viti 1991, atëherë filloni nga ky vit, por mendoj se nëse nuk fillojmë nga fillimi atëherë nuk do të mundeni të bëni asgjë. (Isa Gashi, kryeplak i fshatit Pavlan, Kosovë, konsultimet me komunitetin lokal, Pejë, Kosovë, 28. janar 2010).

Komisioni duhet së pari të filloj punën dhe më pas të fitoj obligime të zgjeruara

(...) ne do t`a kemi komisionin i cili do të formohet, dhe do t`a ngarkojmë aq shumë sa që as qeveria nuk mundet t`i zgjedhë të gjitha këto probleme..(..) dhe duhet t`i ndihmojmë këtij komisioni që sa më parë të formohet dhe të punoj në zbardhjen e fateve të njerëzve, para së gjithash të të zhdukurve...(...) Nëse ky komision do të ketë sukses me kohë dhe nëse shumë shpejt kryen punën atëherë mundemi t`a ngarkojmë me diçka tjetër. Por së pari le të filloj me punë. (Tahir Rraci, ish i burgosur politik nga burgu i Dubravës, Kosovë, Konsultimet me komunitetin lokal, Pejë, Kosovë, 28 janar 2010).